



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “GEB SHPK” të datës 19.07.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Milevc - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-3200-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “GEB SHPK” të datës 19.07.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Milevc - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-3200-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “GEB shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 19.07.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Milevc - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-3200-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritator (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pergjigje me Arsyen se parë eliminuese:

Arsyeja e parë eliminuese është plotësisht e pabazuar dhe përbën një shkelje të rëndë të LPP-së pasi që GOE jonë ka referenca të punimeve në total mbi 10 milion Euro kontrata të realizuara dhe të cilat shumica janë të dëshmuara me referenca dhe pranimë teknike, apo raporte përfundimtare. Listat e projekteve të prezantuar paraqesin gjitha kërkesat e DT pra të dhënat që kërkohen për projektet e përfunduara në 3 vitet e fundit. Dëshmi foto 1

Pra secila kërkesë e listës së DT është plotësuar në listat e dorëzuar nga ne dhe nuk mungon asnjë e dhënë për projektet. Poashtu për qdo mangësi do të mund të kërkohej sqarime shtesë duke u bazuar në Nenin 72 të LPP-së- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Pergjigje me Arsyen se dytë eliminuese:

Sa I përket kësaj pike është plotësisht e pabazuar pasi që nuk mund të përdoret arsye eliminuese për një pikë që s'është kërkuar DT, pra nuk është kërkesë në DT dorëzimi i planit dinamik. Gjithësi planin dinamik e kemi ngarkuar në formë standarte dhe i cili saktësisht paraqet afatin e punimeve për 30 ditë pas fillimit të punimeve.

Pergjigje me Arsyen se tretë eliminuese:

Sikurse edhe arsyet tjera eliminuese dhe kjo është plotësisht e pabazuar pasi që për të gjitha pasjet kemi dorëzuar marrëveshjet e nënshkruar nga të dyja palët dhe ku shprehimisht njëri operatorë ekonomik marr në shfrytëzim gjitha pasijet e operatorit tjetër ekonomik dhe të cilat janë të dëshmuara me libeiza, duda doganor fotografi etj.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina

SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT
KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 - PRISHTINË

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar¹

Nr. i prokurimit⁵ 616-26-3200-5-2-1
Nr i brendshëm 616-26-59-5-2-1

Titulli: “Ndërtimi i rrugëve në Milevc-Ritender”

Të nderuar (a)

Grupi i Operatorëve Ekonomikë GEB SH.P.K. dhe HARST Group SH.P.K.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] është i papërgjegjshëm

Nuk i keni përmbushur kërkesat e DT-së dhe Njoftimit për Kontratë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si GOE-ik me ofertën tuaj nuk kanë arritur të dëshmoni përmbushjen e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, sipas nenit 9.1 dhe 9.2 – Kapaciteti teknik dhe profesional, përkatësisht kërkesën që operatori ekonomik të dëshmojë se ka përfunduar me sukses kontrata të punëve të ngjashme gjatë 3 (tre) viteve të fundit para publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më të vogël se 117,900.00 euro.

Dëshmia e kërkuar ka qenë: lista e kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, ku duhet të specifikohen titulli i kontratës, vlera e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit, përfituesi, si dhe listës t'i bashkëngjiten kontratat dhe referencat ose raportet për kryerjen e punimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit është konstatuar se GOE nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kësaj kërkesë sipas kushteve të përcaktuara në dosjen e tenderit. Për rrjedhojë, oferta konsiderohet e papërgjegjshme për këtë pikë.

⁵ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

Lidhur me afatin e implementimit, në Formularin e Ofertimit dhe në Deklaratën e Operatorit Ekonomik për Afatin e Implementimit të Projektit dhe Periudhën Garantuese, kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë që afati i implementimit të jetë minimumi 30 ditë dhe maksimumi 50 ditë.

GOE në deklaratë ka ofruar afat implementimi prej 30 ditësh, ndërsa në Planin Dinamik ka paraqitur afat prej 20 ditësh, çka paraqet mospërputhje ndërmjet dokumenteve të ofertës dhe është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit. Për këtë arsye, oferta konsiderohet e papërgjegjshme edhe për këtë pikë.

GOE gjithashtu nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas nenit 9.1 dhe 9.2 – Kapaciteti teknik dhe profesional, lidhur me listën e pajisjeve, sipas Aneksit 8 – Pajisjet e nevojshme dhe të obligueshme për realizimin e punimeve.

Gjatë shqyrtimit është konstatuar se, në marrëveshjet e qirasë për makineritë, lideri i grupit ka paraqitur disa marrëveshje pa specifikuar se cilat makineri janë objekt i secilës kontratë. Për pasojë, nuk është dëshmuar në mënyrë të qartë disponueshmëria e pajisjeve të kërkuara sipas Aneksit 8. Rrjedhimisht, GOE nuk ka arritur të dëshmojë se i plotëson kërkesat lidhur me listën e pajisjeve të nevojshme dhe të obligueshme për realizimin e punimeve.

Andaj, ju me ofertën tuaj pas Rivlerësimit të ofertës, konstaton se jeni të papërgjegjshëm, pasi nuk kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt:
Sektori i Prokurimit

Fillimisht duhet sqaruar se një pjesë të arsyeve eliminuese parashtruesi nuk i konteston si të gjetura faktike mirëpo pretendon se ato nuk mund të përdoren si arsye eliminuese. Si shembull parashtruesi nuk e konteston faktin që te marrëveshjet për marrjen me qera të makinerisë nuk janë cituar dhe identifikuar saktë me emër se cilat pajisje janë marrë me qera. Mirëpo parashtruesi pretendon se përderisa e ka shkruar në marrëveshje të gjitha pajisjet e qeradhënësit është i mbuluar në kuptim të kërkesës së DT. Ky pretendim është i pasaktë pasi që komisioni vlerësues për t'u bindur që nuk ka hapësirë për manipulim me dokumentet e ofertuara, duhet të dëshmohet saktësisht cila pajisje me emër dhe numër është marrë me qera, për cilën periudhë kohore, për cilin projekt, kush është qeradhënësi, etj. Vetëm në këtë formë mund të ofrohet siguri e mjaftueshme juridike dhe në fakt vetëm në këtë formë është vlefshme juridikisht marrëveshja me qera. Kjo çështje është e rregulluar përmes nenit 585 të LMD ku përcaktohet se *"Me kontratën për qiranë, qiradhënësi detyrohet që t'ia dorëzojë sendin e caktuar qiramarrësit në përdorim, ndërsa qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiranë e kontraktuar"*. Pra ligji e kërkon shprehimisht që te kontratat e qerasë të specifikohet **"SENDI I CAKTUAR"** dhe nuk logjikë të pretendohet që *"të gjitha sendet"* janë *"sende të caktuara"* sepse edhe gjuhësisht, edhe logjikisht dhe mbi të gjitha ligjërisht (neni 585 i LMD, etj) këto janë nocionet të ndryshme mes vete.

Prandaj ky pretendim është i pabazuar në tërësi. Ngjashëm vlen edhe për pretendimet tjera sic janë pretendimi për aneksin 7 të DT lidhur me listën e kontratave. Parashtruesi nuk e konteston faktin që në DT është kërkuar shprehimisht të plotësohet aneksi 7 i DT dhe parashtruesi e ka dorëzuar një dokument ku thuhet aneksi 6 i DT. Argumenti ku parashtruesi thotë që AK ka mundur të kërkoj sqarime shtesë është i paqëndrueshëm pasi që nuk ka nevojë të kërkohej sqarime shtesë për dicka që është e evidentuar në dokument. Pra aneksi 6 është aneksi 6 ndërsa aneksi 7 është aneksi 7 dhe nuk ka nevojë të kërkohej sqarime për të bërë një dallim të tillë. Dicka tjetër është nëse ky gabim i parashtruesit përbën devijim të vogël ose jo mirëpo nuk mund të mohohet se rrethanë faktike e dokumentuar. Mirëpo edhe nëse do të përbente devijim të vogël, kur të kemi parasysh faktin që parashtruesi është eliminuar edhe për arsye të tjera sic janë kontratat e qirasë, atëherë nga cilido këndvështrim i mundshëm edhe ky pretendim rezulton të jetë jo vetëm i pabazuar por edhe jorelevant. Ngjashëm vlen edhe për dallimet në afatin e implementimit përbrenda planit dinamik. Vlen të shtohet që plani dinamik është përcaktuar edhe në pikën 21.3 të draftit të kontratës të bashkëngjitur si aneks në dosjen e tenderit, ndërsa afati implementuar sipas DT ka qenë nga 30 deri në 50 ditë. Sërish parashtruesi mund të thirret në atë që ka qenë gabim teknik ose devijim i vogël mirëpo kur kjo shiqohet si pjesë e tërësisë edhe me gabimet tjera dhe devijimet tjera, rezulton sërish që edhe ky pretendim është i pabazuar në tërësi. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.07.2026



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.